



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 36/2015

Prishtinë, më 3.11.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

E ftuar: Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Zef Dedaj; Dardan Abazi dhe Visar Berisha, INDEP; Lejla Selimi, OSBE; Fjolla Uka – KDI; Burhan Rexhepi dhe Burim Berisha, OJQ “Liittoo”.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.10.2015;
3. Raportim i znj. Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për zhvillimet në fushëveprimin e ministrisë, në realizimin e prioritetëve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm (Industria, prodhimi, eksporti, sektori i naftës dhe investimet e jashtme);
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.10.2015

Kryetari, kërkoi nga deputetët që nëse kanë ndonjë vërejtje në procesverbal, le t'i adresojnë sot ose t'i dërgojnë te stafi i Komisionit.

Blerim Grainca, tha se ka një vërejtje, të cilën do t'ia përcjellë stafit të Komisionit, me shkrim.

Procesverbali i mbledhjes së datës 20.10.2015, u miratua duke përfshirë vërejtjen e deputetit, Blerim Grainca.

3. Raportim i znj. Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për zhvillimet në fushëveprimin e ministrisë, në realizimin e prioritetëve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm (Industria, prodhimi, eksporti, sektori i naftës dhe investimet e jashtme)

Kryetari, përshëndeti të gjithë anëtarët e pranishëm të Komisionit dhe ministrin e Industrisë, znj. Hykmete Bajrami, të cilën e falënderoi për gatishmërinë e përhershme që ka për bashkëpunim me Komisionin. Ai foli për rëndësinë e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, në aspektin e zhvillimit ekonomik, në të cilën janë shumë çështje të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me fushëveprimin e Komisionit. Në vijim, tha se sigurisht që në bazë të kësaj marrëveshjeje, do të duhet ta rikonsolidojmë gjendjen e Komisionit tonë, që ka të bëjë veçanërisht me planin për vitin e ardhshëm, për të cilin do të fillojmë ta hartojmë që tani. Marrëveshja për Stabilizim-Asociim me Bashkimin Evropian, paraqet hyrjen në një fazë të re në forcimin e shtetndërtimit dhe është një hap më frytdhënës në integrimet euroatlantike. Ne po hyjmë në një proces sfidues për realizimin e aspiratave të Kosovës për ndërtimin e një shteti të prosperuar ku pavarësia, liria dhe demokracia kanë dimensione domethënëse. Po ashtu, z. Mustafa theksoi se ky proces kërkon një vetëdijesim se ne, patjetër, duhet të bëjmë hapa edhe më domethënës për ngritjen e cilësisë së qeverisjes, forcim të institucioneve në aspektin ligjor. Kjo është veçanërisht e nevojshme për qeverisjen ekonomike, pasi që ne jemi në një etapë ku çdo ditë kërkohet të përparohet në dy kërkesat bazike për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Andaj, këto dimensione të ngritjeve ekonomike kanë të bëjnë në krijimin e një ekonomie konkurruese dhe të rritjes së qëndrueshme ekonomike. Vetë Marrëveshja për Stabilizim-Asociim krijon një moment të ri që sjell favore dhe sfida, përfitimet kryesore që kanë të bëjnë me këtë dokument, lidhen me investimet. Prandaj, Kosova do bëhet një vend më atraktiv për investime dhe ne duhet të krijojmë të gjitha parakushtet që të përfitojmë nga kjo situatë, ngase shpeshherë në vorbullën e problemeve politike po na ikin momente mjaft të rëndësishme. Pra, ky është një moment shumë i rëndësishëm që ne ta ngremë imazhin tonë si vend i mirë për investime. Gjithashtu, është i rëndësishëm edhe evitimi i kufizimeve sasiore dhe të tjera, të cilat mund të jenë shumë të rëndësishme për

rritjen e eksportit të Kosovës në BE dhe tash eksporti i Kosovës është më i madh. Përfitim direkt dhe i menjëhershëm është rritja e investimeve financiare direkt dhe indirekt nga Bashkimi Evropian në Kosovë dhe kalim në cilësi, në krahasim me investimet financiare të BE-së në Kosovë, siç e kishim deri tani me instrumentin e para-asociimit. Megjithatë, ne duhet të jemi të vetëdijshëm që kemi sfida të rëndësishme, për arsye se do të rritet konkurrenca në tregun e Kosovës, pasi që produktet nga Bashkimi Evropian do të jenë më të lira, gjë që është mirë për konsumatorët, por kjo do të krijojë një problem për prodhuesit e Kosovës, andaj ne duhet të ndërmarrim masa që kanë të bëjmë me një sistem më të integruar monetar, për ta forcuar aftësinë konkurruese të bizneseve të Kosovës. Megjithatë, në këtë sferë, marrëveshja ka një periudhë disavjeçare, por brenda asaj periudhe disavjeçare, ne duhet t'i shfrytëzojmë të gjitha instrumentet që na lejon kjo marrëveshje, por edhe Organizata Botërore e Tregtisë edhe CEFTA-a. Kosova ka përjetuar një de-industrializim të rëndë gjatë viteve 90-ta dhe ka vazhduar edhe pas çlirimit, për shkak të politikave jo të favorshme, prandaj ajo që i nevojitet Kosovës tani dhe që është prezent në programin qeveritar është një strategji e ri-industrializimit të Kosovës. Ne duhet ta ndryshojmë strategjinë e zhvillimit ekonomik, natyrisht duke mos cenuar konkurrencën e barabartë, duhet të krijojmë masat e nevojshme konkurruese për industrinë prodhuese dhe për shërbimet publike. Komisioni ynë ka përgjegjësi të shtuara sa i përket Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit. Në këtë drejtim, ne do të kemi edhe shumë punë legjislative, po ashtu edhe ministritë të cilat janë të ndërlidhura me Komisionin. Në fund, tha se sipas programit të punës, kemi paraparë që për këtë mbledhje, si pikë e rendit të ditës të jetë, raportimi i znj .Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për zhvillimet në fushëveprimin e ministrisë, në realizimin e prioriteteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe në vitin e ardhshëm (Industria, prodhimi, eksporti, sektori i naftës dhe investimet e jashtme), në mënyrë që deputetët dhe Komisioni, të jenë të informuar rreth aktiviteteve të tyre dhe projekteve të ministrisë, sidomos në sektorin e investimeve të jashtme, pasi që deri më tani, nuk iu ka dhënë ndonjë prioritet dhe ia dha fjalën ministres.

Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në ekspozenë e saj para deputetëve, paraqiti prioritetet, projektet dhe zhvillimet në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Ajo tha se ministria ka vazhduar në realizimin e projekteve dhe shpalosi punët e bëra nga MTI, përgjatë këtyre muajve, duke u ndalur në pikat kryesore të fushëveprimit të MTI-së dhe institucioneve të saj vartëse. Ndër të tjera, ministrja paraqiti aktivitetet, në kuadër të mekanizmit të CEFTA-s, për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, raportin e “Doing Business 2016” të Bankës Botërore, punën e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës, punët rreth përmirësimit të infrastrukturës ligjore dhe asaj fizike për biznesin, dialogun e drejtpërdrejtë dhe mbështetjen e biznesit vendor. Më tej, ministrja foli edhe për projektet tjera të rëndësishme, me të cilat po merret MTI, sikurse projekti për zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës, rregullimin e tregut të brendshëm etj. Po ashtu, znj. Bajrami foli edhe rreth projekteve për periudhën vijuese, në të cilat MTI po punon në mënyrë intensive. Më lejoni t’ju përsërisht të gjithëve dhe t’ju falënderoj për ftesën për të biseduar për aktivitetet e MTI-së për këtë vit dhe planet për vitin 2016. Ajo, fillimisht, uroi për miratimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që shënon një moment vërtet historik për vendin tonë. Siç e dini, pjesa dërmuese e kësaj marrëveshjeje ka të bëjë me çështje tregtare dhe

MTI-në, gjegjësisht Departamentin për Tregti, i cili është i përkushtuar që të punojë në implementimin e saj. Nga takimet formale me anëtarë të Organizatës Botërore të Tregtisë – OBT, kemi shprehur gatishmëri dhe kemi përkrahje për aplikimin e Kosovës për anëtarësim në OBT. Agjencitë dhe departamentet përkatëse të MTI-së kanë vazhduar pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin edhe me organizatat e tjera të specializuara të infrastrukturës së cilësisë, si dhe me Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (RCC). Para një jave, është publikuar raporti i ri i Bankës Botërore për të bërit biznes në vitin 2016, ndërsa ne si MTI e kemi mirëpritur renditjen e Kosovës në vendin 66 nga 189 shtete. Personalisht, mendoj që kjo është një pozitë e kënaqshme, duke pasur parasysh sfidat që i ka kaluar vendi ynë gjatë pjesës së dytë të vitit të kaluar, por edhe në fillim të këtij viti. Siç e dini, Qeveria ka filluar një varg reformash, fiskale e administrative, por raporti i “Doing Business” përfshin vetëm ato që kanë ndodhur deri në qershor të vitit 2015. Roli i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik është dialogu i vazhdueshëm mes Qeverisë, komunave, industrisë dhe sektorit privat, me ç’ rast synohet të intensifikohet një bashkëpunim strategjik. Pavarësisht sfidave, gjatë shtatë muajve të parë të këtij viti, kemi evidentuar rritje të konsiderueshme të investimeve të huaja direkte dhe rritje të numrit të kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë. Të dhënat nga ARBK-ja tregojnë se për nëntëmuorin e parë të këtij viti kemi 346 biznese, me pronarë të huaj, në krahasim me vitin e kaluar, kur ky numër ishte vetëm 148. Rritje në regjistrim kemi edhe te kompanitë vendore, ndërsa shuarjet shënojnë trend më të ulët, krahasuar me tri vitet e kaluara. Sipas të dhënave të siguruar nga BQK, investimet e huaja direkte në periudhën janar – gusht 2015, janë 239.8 milionë euro, që paraqet një rritje të konsiderueshme, krahasuar me periudhën e njëjtë të 3 viteve të fundit (2012-2014). Është miratuar nga Qeveria koncept-dokumenti për Ligjin për investime strategjike. Janë në procesin amendamentimit, Ligji për shoqëritë tregtare, Ligji për naftën dhe produktet e saj, Ligji për falimentim, si dhe një numër udhëzimesh administrative. MTI, përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), në bashkëpunim me komunat, në kuadër të aktiviteteve: “Ditët e Biznesit të Vogel 2015”, organizon konferenca informuese për zhvillimin e sektorit privat, ku diskutohen çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e këtij sektori. Barrierat e prezantuara nga bizneset, sipas sektorëve, adresohen nëpër grupe përkatëse punuese, dhe kur është e nevojshme, edhe në nivel të KKZHE-së. MTI, përmes KIESA-s, ka përkrahur pjesëmarrjen e kompanive të ndryshme nëpër panaire vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të promovimit të produkteve vendore, gjithmonë për të rritur konceptin zinxhiror të vlerës apo cilësisë së shërbimeve dhe produkteve të ofruara nga kompanitë vendore. Janë organizuar edhe vizita të ndryshme me rrjetet e bizneseve në diasporë, si në Vjenë, Cyrih, Dyseldorf, Këln dhe në vende të tjera për t’i siguruar bashkatdhetarët tanë se MTI-ja do të jetë gjithmonë një derë e hapur dhe do të vazhdojë të luajë rol avokues për të gjitha bizneset. Projekti për zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës, në prill të këtij viti, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar kontratën për Brezovicën, me konsorciumin francez “MDP Consulting–Compagnie des Alpes”. Kontrata parasheh një investim prej 410 milionë eurosh dhe punësim të rreth 3.000 punëtorëve. Qeveria ka përmbushur, deri më tani, të gjitha obligimet e saj kontraktuese dhe po bashkëpunon ngushtë me partnerin privat për të përkrahur atë në mobilizimin e fondeve të nevojshme për realizimin e investimeve të parapara në kontratë. Kontrata do të hyjë në fuqi para përfundimit të këtij viti, me kusht që investitori të arrijë që të mobilizojë financat dhe Qeveria të kryejë obligimet e saj. Është investuar në

infrastrukturën fizike. Po ashtu, MTI-ja po ndihmon komunat në funksionalizimin e zonave ekonomike në rajone të ndryshme të Kosovës. Në Parkun e Biznesit në Drenas janë plotësuar të gjitha lokacionet e planifikuara, ku janë vendosur 40 kompani të huaja dhe vendore, si dhe janë të punësuar mbi 400 punëtorë në mënyrë direkte në prodhim dhe ndërtim, derisa rreth 500 punëtorë, indirekt bashkëpunojnë me kompanitë e vendosura në park. Për shkak të interesimit të madh nga bizneset, MTI-ja është duke punuar edhe në zgjerimin e këtij parku industrial me hapësira të reja. Ndërsa, është nënshkruar marrëveshja me Komunën e Suharekës, për ndërtimin e infrastrukturës bazë në zonën agro-industriale”. Me Komunën e Shtimes është nënshkruar marrëveshja për të mbështetur financiarisht komunën për ndërtimin e infrastrukturës së zonës ekonomike - faza e dytë. Ndërkaq, me Komunën e Istogut është nënshkruar marrëveshja për të mbështetur financiarisht komunën për ndërtimin e inkubatorit të biznesit. Kemi në plan themelimin e parkut teknologjik, ku do të akomodohen bizneset e teknologjisë informative dhe telekomunikacionit (ICT). Tregu i naftës, është bërë regjistrimi me GPS i të gjitha pikave shitëse të karburanteve në vend. Më 31 dhjetor 2014, rreth 45% e pikave të karburanteve nuk kanë pasur licenca të vlefshme. Më qëllim të vendosjes së ligjshmërisë në tregun e naftës dhe krijimin e kushteve për konkurrencë të barabartë, Inspektorati i Tregut të MTI-së ka filluar aksionin për mbylljen e pikave të karburanteve që nuk kanë licencë valide. Kjo ka bërë që të gjithë operatorët të aplikojnë për licencim dhe tanimë kanë mbetur pa u licencuar vetëm edhe rreth 30 pika shitëse, të cilat nuk kanë mundur të kompletojnë dokumentacionin e tyre, për shkak të problemeve pronësore. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, nëpërmjet Inspektoratit të Tregut, është duke bërë inspektime të vazhdueshme për kontrollimin e cilësisë së derivateve të naftës. Për momentin, Inspektorati i Tregut, këtë detyrë e ushtron nëpërmjet trupave të autorizuar dhe laboratorëve të akredituar. Për më tepër, Agjencia e Metrologjisë, gjatë periudhës janar – shtator, ka realizuar verifikimin e mbi 419 pikave shitëse të karburanteve, respektivisht ka verifikuar mbi 4443 dorëza, derisa gjatë gjithë vitit 2014 janë verifikuar gjithsej 354 pika shitëse të karburanteve, ndërsa janë verifikuar gjithsej 3804 dorëza. MTI, në takimet me krerët më të lartë të shtetit dhe ministrat relevantë të Qeverisë së Shqipërisë, ka ngritur një sërë rastesh të barrierave të ndryshme tregtare, me të cilat ballafaqoheshin bizneset kosovare. Shqipëria ka siguruar se do të eliminojë aplikimin e barrierave dhe nuk kemi indikacione se ato janë aplikuar përsëri. Sa i përket takografëve ministritë/agjencitë relevante të të dyja vendeve, kanë rënë dakord për tekstin e marrëveshjes dhe vetëm pritet nënshkrimi i saj, e cila do të eliminojë plotësisht këtë barrierë për transportuesit kosovarë. Përveç ndonjë lëvizje vullnetare të stafit apo të atyre që janë pezulluar për shkak të inicimit të procedurave gjyqësore, nuk kemi bërë asnjë largim të drejtorëve të agjencive apo të departamenteve. Projektet për të ardhmen MTI/KIESA, e mbështetur nga SDC-ja, me implementues “Swiss Contact” dhe “Riinvest”, janë duke përgatitur projektin për promovimin e produkteve vendore, që do të zhvillohet në të gjitha qendrat dhe rrjetet e marketeve, në mënyrë që konsumatorëve t’iu ofrohet mundësia për t’i provuar këto produkte vendore, para se ata të vendosin për të blerë një produkt të caktuar. Po punohet në unifikimin e numrit të biznesit, që nënkupton që numri i regjistrimit të biznesit është i njëjtë me numër fiskal dhe çdo numër tjetër do të shërbejë si numër identifikues i biznesit. Po ashtu, MTI-ja planifikon të realizojë një projekt që ka për qëllim certifikimin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve banesorë sipas standardeve ndërkombëtare, me qëllim të sigurimit të cilësisë sa më të lartë dhe

rritjen e konkurrencës së produkteve vendore, si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në tregun ndërkombëtar. Po ashtu, edhe projektet e IPA II dhe negociatat me Bankën Botërore për përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës ligjore e fizike.

Kryetari, theksoi se ishte një prezantim shumë detaj nga ana e znj. Bajrami. Pyeti: ku ka mbetur strategjia e zhvillimit ekonomik, a është para përfundimit? Projektligji për investime strategjike, deri ku ka arritur? Sa është aktive KIESA në promovimin e investimeve të jashtme? Për importin, eksportin dhe për prodhimin vendor nuk kemi të dhëna statistikore të përpunuara, a keni bërë diçka në këtë drejtim, ju si MTI, që t'i kemi këto informacione të përpunuara në formë të të dhënave?

Sala Berisha- Shala, përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ministren, të cilën e falënderoi për raportimin dhe për punët dhe angazhimet e ministrisë, si dhe e uroi për miratimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit.

Raif Qela, tha se MTI-ja e ka ndryshuar klimën e të bërit biznes edhe në fushën e plotësimit të infrastrukturës ligjore. Disa projektligje, deri më tani, veç janë proceduar në këtë Komision dhe kanë vazhduar tutje në Kuvend. Të gjitha këto janë për t'i përshëndetur. Pyeti: sa po ndikon mungesa e bordeve nëpër agjenci të pavarura në klimën e të bërit biznes, sidomos mungesën e tërë Bordit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, si ndikon në klimën e biznesit? Kërkesa i është bërë edhe Qeverisë, që të plotësohet ky bord, por kjo çështje nuk është proceduar fare në Kuvend, kur dihet se në mungesë të tij dëmet janë shumë të mëdha. Pra, nuk ke adresë se ku të ankoresh, dhe si pasojë, ligjërisht nuk mund të luftohet monopoli.

Blerim Grainca, e përgëzoi znj. Bajrami për numrin e madh të angazhimeve që ka bërë brenda ministrisë, në Qeveri, në përgjithësi, të cilat lidhen me ngritjen e konkurrencës, ngritjen e cilësisë, por edhe për ndryshimin dhe qeverisjen në përgjithësi. Ai theksoi se ka cekur edhe në vitin e kaluar që buxheti i ministrisë është më i vogël, sa buxheti i RTK-së, prandaj duhet ta rishikojmë këtë çështje. Po ashtu, z. Grainca, parashtroi disa pyetje, lidhur me parqet industriale dhe zonat ekonomike: a mendoni se kanë dhënë efektin e duhur dhe a keni arritur t'i shikoni, sa po zbatohet ana ligjore në vendosjen e bizneseve? Sa i përket raporteve me Shqipërinë, të gjitha barrierat janë të tejkaluara, siç thatë edhe ju, mirëpo shpeshherë ndodh që të përsëriten të njëjtat probleme, përkundër marrëveshjeve të cilat i bëni me homologët në Shqipëri, sepse kam dëgjuar disa herë edhe ankesa të bizneseve, si p.sh. rritje të kostove, ndalesa në doganë. Ku qëndron problemi? Çështjen tjetër që e ngritët e që lidhet edhe me qasjen dhe mundësinë që t'ju jepet bizneseve kosovare për të pasur qasje në fonde apo grande të caktuara, këto grande ju thatë që po i përcillni, a kanë dhënë efektin e duhur, gjegjësisht a kanë ndikuar në rritjen e punësimit, shërbimeve dhe cilësisë që ofrojnë këto kompani? Për çështjen e Brezovicës, ku thuhet se ka vonesa, mirëpo ju e thatë se është brenda afatit kohor. A do të arrijë partneri që të përmbush obligimet dhe a ka rrezik që të dështojë edhe projekti i Brezovicës, sikurse janë problemet të cilat i kemi në sektorin e energjisë, vonesat e caktuara me investitorët apo jeni të siguritë që do t'i përmbushë obligimet në afatin e kërkuar? Në fund, z. Grainca e përgëzoi për katër ligjet që kanë arritur t'i përfundojnë

dhe uroi që sa më shpejt ta sjellin edhe projektligjin për naftën, sepse, siç e dini, është një sektor mjaft problematik në Kosovë, por që shumë shpejt do të arrini të vendosni kontrollin edhe në këtë fushë. Sa i përket idesë suaj, që çështja e kontrollit të bëhet në pikat e depove, kjo duket si ide e mirë.

Besim Beqaj, lidhur me çështjen e Brezovicës, kërkoi sqarime, sepse ende ka dilema, dhe nuk dihet a do të gjejë bashkëpunëtorë për t'i ndihmuar financiarisht apo janë vonesa për të prezantuar një plan master. Një çështje tjetër që lidhet me ambientin në nivel rajonal, sigurisht keni dëgjuar që Shqipëria ka bërë disa masa, të cilat nuk janë shumë korrekte. Ata kanë bërë një taksë për transportuesit tanë, të cilët shkojnë në Shqipëri të bëjnë skanimin e maunave. Kjo situatë ka qenë edhe e mëhershme. Unë kam qenë edhe personalisht dy herë në Shqipëri për këtë çështje, por që tani, realisht, është në përmirësim e sipër. Kjo krijon kosto dhe nuk është fjala vetëm për skanim, por që do të krijojë edhe një shpenzim ekstra tek ndërmarrjet tona. Po ashtu, një taksë e re, të cilën nuk e di a është taksë, ku transportuesit kur hyjnë në territorin e Shqipërisë, nuk duhet të kenë më shumë se 200 litra naftë në rezervarët e tyre. Lidhur me këtë, kam pasur edhe takime dhe diskutime në Shqipëri, ndërsa është thënë se po e parandalojnë kontrabandën dhe gjërat tjera. Ato arsyeime nuk mund të qëndrojnë, sepse ata mund ta kontrollojnë sasinë. Për momentin, ka penale të ndërmarrjeve tona deri në 1 mijë euro. Penalet shkojnë për tejkalim të kësaj sasive 200 litra naftë dhe besoj që kjo është diçka për të cilën ju duhet ta trajtoni me fokus shumë të lartë. Andaj, ministra është e përgjegjshme edhe për barrierat tarifore dhe jotarifore dhe besoj që kjo do të ishte një çështje që këta ta perceptonin edhe më fuqishëm.

Fatmir Rexhepi, lidhur me MSA-në, tha se është një test i mirë për këtë fazë transitore. Po ashtu, do të jetë një matëse e mirë për punën e Kuvendit në aspektin e përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së. Për të bërit biznes, tha se po shihet që po shkon drejt progresit, por duhet që edhe investimeve të brendshme t'u jepet prioritetet. Ai theksoi se lidhur me panaiet ndërkombëtare që po organizohen jashtë vendit, po mungon koordinimi i ambasadave të Kosovës dhe të ngarkuarve që janë për çështje ekonomike se nuk po kryejnë punën e vet, në raport me prodhuesit e Kosovës, për t'ju ndihmuar në promovimin e produkteve vendore. Pyeti: sa është investuar deri më tanin nga MTI-ja në Parkun Industrial në Drenas? Për bashkëpunimin me Shqipërinë, tha se po dalin vazhdimisht barrierat dhe po gjobiten kompanitë tona, sidomos kjo që u theksua për naftën. Andaj, është mirë që ju si ministri të bëni një reagim dhe të sqaroni se ku qëndron problemi.

Ministrja Hykmete Bajrami, iu përgjigj pyetjeve dhe dha sqarime për çështjet që u parashtruan. Lidhur me barrierat me Shqipërinë, tha se po bisedojmë që të gjitha problemet që po paraqiten, t'i zgjidhim me një marrëveshje bilaterale në mes të dy vendeve. Për mungesën e Bordit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, tha se është një pengesë, por kemi marrë vendime në Qeveri, që të shthuret monopoli në treg, derisa të zgjidhet Bordi i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Për zonat ekonomike, tha se nuk do t'i quajmë zona ekonomike, por zona industriale, sepse Kosova është një territor i vogël dhe kemi respektuar kriteret për të pasur vetëm zona industriale, pasi që zonat ekonomike përfshijnë një hapësirë më të madhe të zhvillimit të bizneseve dhe kanë edhe

implikime fiskale. Për shumën e mjeteve financiare se sa është investuar deri më tani në ndërtimin e Parkut Industrial në Drenas, tha se tani për tani nuk mund të them shumën e saktë, pasi nuk i kam të dhënat me vete, por do t'ua sjellë me shkrim. Për përfitimin e grandëve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, tha se ky projekt ka qenë në bashkëfinancim me donatorët e BE-së dhe kriteret kanë qenë të hartuara së bashku me donatorin e Komisionit Evropian. Për projektin e Brezovicës, tha se përfundimi do të jetë deri më 24 dhjetor të këtij viti. Sa i përket anës sonë si MTI, të gjitha obligimet që i kemi pasur për investime, si ministri, i kemi përfunduar, ndërsa kompania investuese në këtë projekt i ka ndarë punët në segmente. Sa i përket investimeve, besojmë se nuk do të dështojë kompania investuese. Për naftën, tha se pas miratimit të ligjit të ri, nafta e importuar fillimisht duhet të vendoset në depo dhe aty do të bëhet kontrolli i cilësisë, ku deri më tani janë 10 kompani që kanë depo. Për çështjen e statistikave për qarkullimin mallrave në eksport dhe importe, tha se Agjencia e Statistikave është në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Këto të dhëna statistikore mund t'i kërkon në këtë agjenci. Ne si MTI, kemi dyshim në gjithë këtë import. Për agjencinë e KIESA, tha se është zgjedhur drejtori i ri dhe është duke e kompletuar stafin, ndërsa e kemi në plan një vizion të ri për promovimin e investimeve të jashtme dhe të ndërmarrjeve vendore.

Besim Beqaj, lidhur me privatizimin e qendrës së skijimit në Brezovicë, tha se prona është shpronësuar në masë të madhe, por kanë dalë dokumente që ky shpronësim është bërë një herë, ekzistojnë dokumente që janë në Komunën e Ferizajt. Prandaj, kjo çështje duhet të rishikohet edhe një herë, sepse ka dokumente që dëshmojnë që një pjesë e këtyre pronave, janë shpronësuar dhe janë prona publike.

Fatmir Rexhepi, pyeti: cilat zona industriale për zhvillim ekonomik i keni në plan, por që ende nuk e keni bërë deri më tani?

Blerim Grainca, rreth depove të naftës kërkoi që MTI-ja të lejojë më shumë depo të naftës, pasi që ka resurse të mjaftueshme që mund t'i kontrollojë këto depo të naftës.

Ministrja Hykmete Bajrami, iu përgjigj pyetjeve të parashtruara. Lidhur me zonat industriale, tha se ka qenë një vendim i Qeverisë, i vitit 2013, që të zvogëlojnë hapësirën e shpronësimit, ndërsa ndërtimi i zonave industriale do të bëhet në bazë të kërkesave të komunave. Për zonën industriale që e kemi në plan, tha se kemi kërkuar nga komunat që të gjejnë një hapësirë të përbashkët më të madhe, në mënyrë që ta kemi më të lehtë investimin, qoftë në shpronësim apo edhe në infrastrukturë. Për buxhetin që i ndahet MTI-së, tha se kanë problem buxhetor, sepse na është ndarë një buxhet shumë i vogël, në krahasim me kërkesat që i kemi.

Zef Dedaj, drejtor në Departamentin e Tregtisë, lidhur me problemet e bizneseve që po dalin në Doganën e Shqipërisë, tha se jemi duke bashkëpunuar vazhdimisht me autoritetet e Shqipërisë, që këto barriera t'i zgjidhim. Për skanerët në pikën kufitare, ende nuk e kemi zgjidhur, ndërsa për kontrollimin e rezervarëve të naftës që iu bëhen transportuesve të mallrave, e kemi marrë konfirmimin nga pala e Shqipërisë, se është zgjidhur. Për çështjen e doganës dhe CEFTA-s me Shqipërinë, tha se janë probleme që

priten të zgjidhen, në mes të dy shteteve. Në raport me Serbinë, janë zgjidhur disa probleme, duke u bazuar në marrëveshjen e CEFTA-s.

Kryetari, tha se kemi pasur një diskutim shumë përmbajtjesor dhe kemi rezultate të dukshme nga ministra. Theksoi që ministrja Bajrami do ta ketë mbështetjen e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për punën që po bën ministria që ajo drejton. Lidhur me buxhetin, tha se gjatë shqyrtimit në Komision, ne do t'u japim prioritet politikave ekonomike dhe ju rekomandoj që ta keni prioritet buxhetin dhe 4-5 çështje në sektorë kyç në MTI, pasi që ministria që ju drejtoni, ka një fushë të gjerë të veprimtarisë dhe është e pamundur t'ju jepni prioritet të gjithë sektorëve. Anëtarët e Komisionit dhe ministrja Bajrami, u dakorduan që ky bashkëpunim të vazhdojë më tutje në frymën e qëllimit të përbashkët, përmirësimin e vazhdueshëm të ambientit të biznesit në vend, si parakusht për krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjes ekonomike.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këto

K o n k l u z i o n e

- 1. Komisioni dhe Ministria të vazhdojnë bashkëpunimin në frymën e qëllimit të përbashkët, përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit të biznesit në vend, si parakusht për krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjes ekonomike.*
- 2. Ministria të angazhohet në adresimin e shqetësimeve të ngritura nga anëtarët e Komisionit.*

4. Të ndryshme **Çështje vijuese**

- a) Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit për tryezën që Komisioni e organizon në bashkëpunim me INDEP-në, që do të mbahet nesër, më 4.11.2015, në orën 10:00.
- b) Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se do të ketë një vizitë në Kuvendin e Shqipërisë, më datë 16-18.11.2015, ku do të mbahet një mbledhje e përbashkët me Komisionin homolog dhe vizita sipas kërkesës së grupit të punës, që e ka hartuar Ligjin për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare. Delegacioni do të jetë në këtë përbërje: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi dhe Blerim Grainca, si dhe zyrtarët nga stafi i Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa